



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 10.7.2018

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DENONCIMIN E MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË,
PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN “RIFINANCIMI I
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË ZONAT URBANE DHE
RURALE, FAZA E DYTË, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.86, DATË 23.07.2015”**

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 10 korrik 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë, ratifikuar me ligjin nr.86, datë 23.07.2015”. Komisioni caktoi si relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Elena Xhina. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, si dhe në nenin 29 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është shfuqizimi dhe denoncimi i marrëveshjes së nënshkruar në datën 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, të miratuar me ligjin nr.86/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”. Nga momenti i dekretimit të marrëveshjes qeveritare dhe deri më sot marrëveshja nuk është bërë efektive asnjëherë.

Pala gjermane, nëpërmjet kanaleve diplomatike, ka propozuar një projekt marrëveshje të re për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive”, duke vënë në dispozicion një shumë financimi në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) euro, duke mbështetur dhe promovuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale.

Shkak për moszbatimin e marrëveshjes ka qenë mungesa e një fondi të veçantë garancie për kreditimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, që do të shërbente për kreditimin e tyre nga bankat e nivelit të dytë. Por ky instrument nuk mund të zbatohet sepse nuk ishte i parashikuar në kushtet e marrëveshjes, të miratuar në ligjin nr.86/2015. Në këto kushte, kjo marrëveshje nuk u zbatua kurrë dhe nuk ka pasur asnjë disbursim fondesh.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORE

Elena XHINA

KRYETARI

Ulsi MANJA